

Ligji për Zonat Ekonomike: ndikimi i tij në zhvillimin e parqeve të biznesit

HYRJE

Për të lehtësuar punën e bizneseve, në vitin 2009 Qeveria e Kosovës miratoi Ligjin për Zonat Ekonomike¹, që kishte për qëllim krijimin e zonave të caktuara², ku bizneset do të kishin kushte më të mira në krahasim me pjesët tjera të Kosovës për të zhvilluar veprimtarinë e tyre, respektivisht qasje më të lehtë në transport, energji, ujë dhe shërbime tjera të domosdoshme për bizneset. Nga përvoja e shteteve të zhvilluara kuptohet se funksionimi i zonave ekonomike ka qenë një element i rëndësishëm në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të vendit. Dhe kjo praktikë do të duhej të ishte e dobishme edhe për Kosovën.

Mirëpo, përveç sjelljes së bazës ligjore për krijimin e zonave ekonomike, funksionimi i tyre në Kosovë nuk ka qenë edhe aq i suksesshëm deri më tani. Që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Zonat Ekonomike, Qeveria e Kosovës ka shpallur vetëm dy zona si zona ekonomike: Parkun e Biznesit në Drenas dhe Parkun Teknologjik në Skenderaj, prej të cilave kjo e fundit ka dështuar tërësisht si projekt. Në anën tjetër, në gjashtë komuna të tjera të Kosovës janë krijuar parqe të biznesit apo inkubatorë të biznesit, por që asnjëra nga to ende nuk është shpallur si zonë ekonomike nga ana e Qeverisë. Megjithatë, Qeveria vazhdon t'i promovojë ato si zona ekonomike edhe pse nuk i ka legalizuar. Përveç që nuk janë të legalizuara nga ana e Qeverisë, në parqet e biznesit vërehen një varg problemesh: disa janë larg kompletimit të infrastrukturës, nëpër parqe janë vendosur biznese të ndryshme që për nga natyra e veprimtarisë mund të konsiderohen të rrezikshme për njëra tjetrën, nëpër inkubatorë të biznesit janë vendosur organizata dhe shoqata të ndryshme në vend të bizneseve, etj. Në anën tjetër edhe raportet e fundit të Bankës Botërore (Të bësh Biznes në Kosovë) i japin një vlerësim negativ Kosovës sa i përket ambientit të të bërit biznes, madje sipas Bankës Botërore ambienti i të bërit biznes është përkeqësuar në dy vitet e fundit.

¹Ligji nr. 03/L-129 për Zonat Ekonomike, i miratuar më 30 prill 2009.
http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-129_al.pdf

²Sipas Ligjit për Zonat Ekonomike në Kosovë me "zonë ekonomike" nënkuptohet një zonë gjeografike në kuadër të territorit shtetëror, që ka një status të veçantë ekonomik, e krijuar për qëllime të promovimit, zhvillimit të bizneseve.

Me anë të kësaj analize, Instituti GAP ka për qëllim të identifikojë problemet me zbatueshmërinë e Ligjit për Zonat Ekonomike, të analizojë nivelin e zhvillimit të parqeve dhe inkubatorëve të biznesit si dhe ndikimin e tyre ekonomik në komunat përkatëse. Në këtë analizë janë ofruar edhe një varg rekomandimesh për Projektligjin e ri për Zonat Ekonomike që pritet të miratohet gjatë viti 2012.

Baza ligjore për Zonat Ekonomike

Ligji për zonat ekonomike rregullon krijimin, funksionimin, mbikëqyrjen dhe zhvillimin e zonave ekonomike, të drejtat dhe detyrat e zhvilluesve, operatorëve menaxhues, shfrytëzuesve që veprojnë në to, llojin e veprimtarive që kryhen brenda tyre, si dhe mënyrën e përcaktimit të lokacionit për zonat ekonomike. Krijimi i zonave ekonomike ka për qëllim të ndihmojë zhvillimin ekonomik në vend, veçanërisht atë privat, të nxisë investimet, të hap vende të reja pune, të tërheq teknologjitë e përparuara, të rrisë konkurrencën e biznesit vendor, etj. Sipas ligjit në fjalë, të drejtën e inicimit të krijimit të zonës ekonomike e ka kuvendi komunal, komuniteti i bizneseve, partneriteti publiko-privat dhe vetë MTI, me kusht që ndërtimi i zonës të financohet nga buxheti i Kosovës. Dhe, nëse janë plotësuar të gjitha kushtet për krijimin e zonës ekonomike, është vetë Qeveria e Kosovës e cila nxjerr vendim për shpalljen e zonës ekonomike, me ç'rast definohet statusi i zonës (zonë ekonomike/industriale, park industrial/teknologjik), përcaktohen kufijtë e zonës, llojet e veprimtarive, mënyra e dhënies së zonës (qira apo koncesion), etj.

Por, sa ka ndihmuar ky ligj në zhvillimin e zonave ekonomike në Kosovë dhe sa të tilla janë shpallur që nga hyrja në fuqi e këtij ligji? Që nga viti 2009 Qeveria e Kosovës ka shpallur vetëm dy zona ekonomike, Parkun e Biznesit në Drenas dhe Parkun Teknologjik në Skenderaj.³ Kur dihet se ky i fundit ka dështuar krejtësisht si projekt, rezultati i Qeverisë brenda tre vjetësh ka qenë vetëm një zonë e krijuar. Megjithatë, gjatë këtyre viteve janë krijuar një numër i parqeve të biznesit edhe në gjashtë komuna të tjera të Kosovës. Disa nga to janë tejet funksionale, disa janë në fazën e kompletimit të infrastrukturës dhe disa në fazën fillestare të ndërtimit. Edhe pse asnjë nga to nuk është 'legalizuar' nga ana e MTI, dhe si pasojë edhe nuk është shpallur zonë ekonomike nga ana e Qeverisë, MTI vazhdon t'i promovojë ato si zona ekonomike.⁴ Promovimi i tyre në njërin anë krijon përshtypjen se legalizimi i tyre nuk është i domosdoshëm dhe si rezultat parqet e biznesit mund të funksionojnë edhe pa Ligjin për Zonat Ekonomike. Dhe në anën tjetër ngre dilemën nëse e gjithë procedura për legalizim është tepër e ndërlikuar.

³ Më shumë për këtë vendim të Qeverisë në <http://www.gapmonitor.org/?id=2&n=155>

⁴ http://sme-ks.org/repository/docs/Zonat_Ekonomike.pdf

Me qëllim të përmbushjes së bazës ligjore, Ligji për Zonat Ekonomike parashihte edhe nxjerrjen e akteve nënligjore. Gjatë vitit 2009 Qeveria kishte miratuar gjithsej 5 udhëzime administrative të cilat ishin paraparë sipas Ligjit për Zonat Ekonomike. Këta Udhëzues Administrativë rregullojnë mënyrën e themelimit të zonave ekonomike, procedurat për aplikim, përgjegjësit e institucioneve relevante, mbikëqyrjen e bizneseve dhe nivelin e taksave për operimin e bizneseve. Në vazhdim paraqesim një përmbledhje të shkurtë të këtyre akteve nën ligjorë.

- ***Udhëzimi Administrativ Nr. 2009/14 për themelimin e divizionit të zonave ekonomike*** – përcakton organizimin, fushë-veprimtarinë dhe funksionimin e Divizionit për Zonat ekonomike. Ky divizion funksionon në kuadër të Agjencisë për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NMV), respektivisht Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Divizioni për zonat ekonomike është përgjegjës për hartimin e politikave dhe planeve për zhvillimin e zonave ekonomike, funksionimin e zonave, menaxhimin etj.
- ***Udhëzimi Administrativ Nr. 2009/23 për procedurën për aplikim dhe kriteret e pajisjes me vendim të zhvilluesit*** - përcakton procedurat për aplikim si dhe kriteret që duhet t'i plotësojë inicuesi për marrjen e vendimi për krijimin e Zonës Ekonomike. Sipas këtij dokumenti janë gjithsej 11 procedura dhe 8 pëlqime nga ministritë përkatëse të cilat duhet realizuar për t'u pajisur me leje për krijimin e një Zone Ekonomike:
 - Akti i themelimit (regjistrimi, statuti, etj)
 - Arsyeshmëria (elaborati/studimi i fizibilitetit) për krijimin e Zonës Ekonomike
 - Dëshmia mbi pronësinë e Zonës Ekonomike – kopjen e planit dhe fletën poseduese, e cila nuk mund të jetë më e vjetër se 6 muaj
 - Plani rregullues urban me infrastrukturën përcjellëse
 - Pëlqimin nga institucionet përkatëse:
 - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
 - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – VNM
 - Ministria e Energjisë dhe Minierave
 - Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
 - Komuna përkatëse
 - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve – Trashëgimia Kulturore
 - Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit
 - Burimi i financimit dhe mbështetja financiare
 - Kohëzgjatja e operimit të zonës ekonomike,

- Kushtet dhe kriteret tjera që parashihen me nenin 4, 5 dhe 7 të Ligjit për Zonat Ekonomike
- Plani për trajtimin e ujërave të zeza
- Plani për furnizim me ujë
- Fletë pagesën për aplikim

Sipas këtij UA nëse aplikuesit i mungon dokumentacioni i kompletuar, i jepet edhe një afat prej 30 ditëve për plotësimin e tyre. Megjithatë ky UA nuk tregohet se çfarë ndodh nëse edhe pas 30 ditëve dokumentacioni nuk është i plotësuar.

- ***Udhëzimi Administrativ Nr. 2009/24 për marrëdhëniet ndërmjet institucioneve përgjegjëse, zhvilluesit të zonës dhe institucioneve të tjera*** – rregullon marrëdhëniet ndërmjet këtyre palëve duke i përcaktuar detyrat e secilit prej tyre, e njëherazi edhe i obligon ato të mbajnë kontakte të vazhdueshme për të gjitha çështjet rreth Zonës Ekonomike.
- ***Udhëzimi Administrativ Nr. 2009/25 për procedurat e kontrollit të Zonave Ekonomike*** - përcakton procedurat dhe veprimet e ndërmarra për mbikëqyrjen dhe kontrollimin e zonave ekonomike. Sipas këtij dokumenti nëse zhvilluesi i Zonës Ekonomike nuk i respekton rregullat e përcaktuara me kontratë, Agjencia për Promovimin e NVM i jep vërejtje me shkrim dhe afat prej 60 ditësh për përmirësimin e parregullsive, e nëse edhe pas 60 ditëve zhvilluesi nuk e përmirëson situatën, atëherë Agjencia inicion procedurën për ndryshimin e vendimit, duke i dhënë afat 24 orësh për ndalimin e veprimtarisë së shfrytëzuesit.
- ***Udhëzimi Administrativ Nr. 2009/26 për formën, përmbajtjen, vlefshmërinë dhe taksën për dhënien e vendimit***. Ky vendim jepet nga institucioni përcaktues dhe përmban kriteret që i përcakton UA. Sipas UA nëse aplikuesi nuk i plotëson kushtet, atëherë atij i lëshohet vendimi refuzues. Pas përfundimit të afatit të shfrytëzimit, aplikuesi ka një afat prej 6 muajsh për ri-aplikim. Me rastin e paraqitjes së kërkesës aplikuesi paguan një taksë prej 1,000 euro. Taksa për dhënien e vendimit është 200 euro për hektar, ndërsa nëse zgjatet vendimi atëherë aplikuesi paguan 50% të vlerës së taksës për pajisje me vendim.

Me gjithë ekzistimin e ligjit për zonat ekonomike dhe të pesë udhëzimeve administrative që shpjegojnë procedurat për krijimin dhe legjitimimin e zonave ekonomike, sot Kosova ka të shpallur vetëm një të tillë. Përfundimisht, ligji për zonat ekonomike nuk ka ndikuar aq shumë në tërheqjen e investitorëve të huaj, në hapjen e vendeve të reja të punës apo grumbullimin e bizneseve prodhuese në një vend. Për këtë Qeveria e Kosovës në Programin Legjislativ 2012, ka paraparë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Zonat Ekonomike gjatë këtij viti.

Funksionaliteti i parqeve të biznesit në Kosovë

Në përgjithësi zonat ekonomike njihen si parqe të biznesit, parqe teknologjike, apo parqe industriale. Ndërkaq brenda parqeve por edhe jashtë tyre ka edhe inkubatorë të biznesit, të cilët kanë për qëllim grumbullimin e bizneseve të vogla dhe të mesme në një objekt. Në Kosovë deri më tani janë marrë gjithsej 10 iniciativa për krijimin e zonave ekonomike në 8 komuna të ndryshme të Kosovës. Prej tyre 5 janë të llojit “parku i biznesit”, 4 janë të llojit “inkubator biznesi” dhe 1 është i llojit “parku industrial”. Sipas një broshure promovuese të nxjerrë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (2010), Zonat Ekonomike në Kosovë përfshinë këto parqe të biznesit: Parku i Biznesit dhe Inkubatori i Biznesit - Drenas, Parku i Biznesit Holandez - Prizren, Parku i Biznesit - Suharekë, Parku i Biznesit - Mitrovicë, Parku Industrial dhe Inkubatori i Biznesit - Shtime, Inkubatori i Biznesit - Deçan, Inkubatori i Biznesit - Gjilan.

Para se të analizohet efikasiteti i parqeve të biznesit dhe ndikimi i tyre në ekonominë e vendit, duhet të shikohet se sa në të vërtetë janë funksionale ato. Sot shumica e parqeve të biznesit janë gjysmë funksionale, ka ngecje në ndërtimin e infrastrukturës së parkut, ka një përzierje të veprimtarive biznese brenda një parku qofshin ato edhe të rrezikshme për njëra tjetrën, ka inkubatorë të biznesit me asnjë biznes, si dhe ka parqe që kanë dështuar tërësisht si projekt, të inicuar në bazë të modelit publiko-privat. Më poshtë kemi pasqyruar gjendjen aktuale në disa nga parqet e biznesit në Kosovë.

Megjithëse punimet për ndërtimin e **Parkut të Biznesit në Drenas** kanë nisur që nga viti 2005, sot në të kanë filluar punën jo më shumë se 12 firma, disa janë në ndërtim të objekteve dhe disa ende nuk kanë vënë themelet. Ky park ka gjithsej 57 parcela dhe që të gjitha janë të zëna. Por shumë nga firmat përfituese jo vetëm që nuk kanë nisur të operojnë por as që nuk i kanë ndërtuar objektet biznese. Me qëllim që parku të bëhet sa më parë funksional, MTI është dashur që të specifikojë në kontratën e lëshuar për dhënien e parcelës edhe afati kohor kur një biznes do të duhej të fillonte së operuari. Inkubatori i biznesit që ndodhet brenda parkut përveç që është ndërtuar si objekt ende nuk është funksional. Ndër përparësitë e këtij parku është lokacioni i tij pranë autostradës, ka sigurim dhe kontroll në hyrje të parkut, ka internet pa pagesë dhe mirëmbajtje të mire. Megjithatë, problem mbetet ndërprerja e rrymës dhe ujit sikurse në pjesët tjera të vendit. Ndërtimi i këtij parku është financuar nga Qeveria e Kosovës, e cila edhe menaxhon me të.

Parku i Biznesit në Skenderaj, i njohur edhe si parku teknologjik, ka qenë një ndër parqet më të reklamuar nga ana e Qeverisë si një iniciativë për ngritjen e zhvillimit ekonomik. Në këtë park, i iniciuar sipas modelit publiko-privat, ishin planifikuar të hapeshin 33 biznese, të cilat do të krijonin rreth 400 vende pune. Në vitin 2008, Komuna e Skenderaj kishte marrë vendim që kompanisë slovene ‘Tehnopolis’ LLC-Celje t’i jepet për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme për ndërtimin e parkut teknologjik. Më 26 korrik 2011, si pasojë e mospërbushjes së detyrimeve të

përcaktuara për kontratë, për ndërtimin e Parkut Teknologjik, në afërsi të ish-Fabrikës së Municionit dhe Gjuetisë në Skenderaj, autoritetet komunale kishin marrë vendim për shkëputjen e kontratës me kompaninë sllovene 'Tehnopolis' nga Celja.⁵ Përfundimisht ky projekt ka dështuar.

Ndërtimi i **Inkubatorit të Biznesit në Gjiilan** është financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian dhe hapja e tij u bë në shtator 2007. Sot në Inkubator mund të vendosen deri në 20 firma, por që aktualisht veprojnë vetëm 8, të cilat kryejnë këto shërbime: auditor privat, medalje punues, shtypshkronje-fotokopje, madje gjeodezike, kontabilitet, importues i kripës, dhe riparim i kompjuterëve.⁶ Për t'u vendosur në këtë inkubator kusht është që të jetë biznes i ri, të ketë një plan biznesi dhe kompania të jetë sa më inovative. Përparësi për kompanitë është se në tre muajt e parë janë të liruar nga qiraja, kurse më pas qiraja është 2 euro për metër katror. Aktualisht numri total i të punësuarve në këtë inkubator nuk është më shumë se 25. Komuna e Gjiilanit, e cila menaxhon inkubatorin, e ka shpallur atë si ndërmarrje publike, por që legalisht ai nuk njihet si ndërmarrje publike sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike.⁷

Në **Shtime as Parku Industrial e as Inkubatori i Biznesit** nuk funksionojnë si duhet. Në Parkun Industrial vetëm dy objekte janë ndërtuar, ku vetëm njëra nga to është duke operuar. Kjo është një firmë vendore e cila merret me përpunimin e perimeve. Por, në përgjithësi punimet në këtë park kanë ndaluar dhe përveç rrafshimit të terrenit asgjë më shumë nuk është bërë. Parcelat e këtij parku ende nuk janë ndarë, përveç dy sosh për firmat e lart përmendura. Ndërkaq, në Inkubatorin e Biznesit nuk operon asnjë biznes i vetëm. Inkubatori është i vendosur në një ish-objekt shkollor, dhe këto zyre u janë dhënë shoqatave të ndryshme, siç janë shoqata rinore, shoqata e bletarëve, etj.⁸ Shoqatat janë të liruara edhe nga qiraja. Në përgjithësi edhe parku industrial edhe inkubatori i biznesit aktualisht janë larg përmbushjes së objektivave të tyre.

Parku i Biznesit në Suharekë, i njohur edhe si zona industriale, është ndër parqet më funksionale në Kosovë. Aktualisht në këtë park kanë nisur punën gjithsej 40 firma të ndryshme, kurse 20 të tjera janë në pritje të lejes së ndërtimit nga MTI. Firmat konkurruese për lokacion në zonën industriale duhet t'i plotësojnë këto kushte: të kenë biznesin e regjistruar, garancion bankar, projektin ideor, numrin e punëtorëve, etj.⁹ Veprimtaria e firmave

⁵ Komuna Skenderaj <http://kk.rks-gov.net/skenderaj/News/Deshton-Parku-Teknologjik--Tehnopolis%E2%80%9D.aspx>

⁶ Intervistë me menaxherin e këtij inkubatori Z. Sahit Abazi, 26.04.2012

⁷ Komuna e Gjiilanit nuk ka një vend për ta shpallur si Zone Ekonomike. Megjithatë, një marrëveshje është arritur me Komunën e Novobërdës, ku në fshatin Llabjan pritet të ndërtohet një Zonë Ekonomike me hapësirë 74 hektarë. Por, së pari nevojitet kryerja e studimit të fizibilitetit, për të cilën MTI nuk ka buxhet, dhe pastaj duhet të merret leje nga AKP për të shfrytëzuar atë tokë.

⁸ Bisedë me z. Bashkim Ahmeti, Përgjegjës për Regjistrim të Bizneseve, Komuna e Shtimes, 2.5.2012

⁹ Bisedë me Znj. Arlinda Gashi, Qendra e Biznesit, Komuna e Suharekës, 2.5.2012

ekzistuese përfshin: depo ushqimore, përpunues i elementeve nga betoni, prodhues të dyerve dhe dritareve nga plastika dhe alumini, përpunues të lëkurës, përpunues të armaturës, prodhim i pijeve, përpunues i rrushit, etj. Në këtë park ka edhe firma për përpunimin dhe deponimin e gazit, hipodrom, si dhe çerdhe për fëmijë. Mos specifikimi i parqeve të biznesit në Kosovë bën që të kemi veprimtari të ndryshme brenda një parku, e që disa nuk do të duhej të ishin pranë njëra tjetrës, sikurse deponimi i gazit dhe çerdhja për fëmijë. Vlera më e lartë e një investitori është 3 milion euro. Niveli i qirasë varet nga sipërfaqja e parcelës, kurse kohëzgjatja e kontratës është 99 vjet. Numri i punëtorëve të deklaruar nga firmat ekzistuese në total është 764. Problemi në këtë park është se vetëm 5 nga firmat janë të pajisura me leje ndërtimi, disa janë në proces dhe disa kanë marrë pëlqimin por ende nuk janë pajisur me leje ndërtimi.

Mangësitë e Ligjit për Zonat Ekonomike

Tregu i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë është mjaft i dobët, me gjithë faktin se shumica e bizneseve që operojnë në Kosovë janë të kësaj natyre. Përveç tregut të vogël, këto ndërmarrje ballafaqohen edhe me probleme të shumta strukturore, siç janë procedurat e vështira për kredi, procedurat burokratike për hapje të biznesit, taksat dhe tatimet, mungesa e këshillave ligjore dhe teknike, etj. Zonat Ekonomike të krijuara në Kosovë nuk kanë ofruar përfitime të mjaftueshme për rritjen dhe zhvillimin e këtyre ndërmarrjeve. Për më tepër ato kanë dështuar edhe në thithjen e investimeve të huaja në Kosovë, ashtu siç u promovuan në fillim. Po të shohim trendin e Investimeve të Huaja në Kosovë, do të shohim se ajo është në rënie e sipër që nga viti 2007.

Megjithëse operimi në këto zona u ofron investitorëve një varg përparësish siç është qasja më e lehtë në infrastrukturë, dalje në rrugët kryesore, qira të volitshme, siguri më të madhe për bizneset, megjithatë, ekzistojnë edhe probleme të shumta me të cilat ballafaqohen investitorët.

Një problem me të cilin janë ballafaquar bizneset kosovare që kanë investuar ose planifikojnë të investojnë në këto zona është edhe infrastruktura fizike, e cila nuk ka qenë ashtu siç është planifikuar dhe promovuar. Stërzgjatja e punimeve dhe procedurat e tepërta kanë bërë që të humbet interesimi i bizneseve qofshin vendore apo të huaja. Madje këto kanë ndikuar që edhe kostot e planifikuara investuese të rriten, siç është rasti me investimet në furnizim me energji elektrike në Drenas, të cilat është dashur të rriten nga 2.000kV në 8.000kV. Për më tepër, vetë ligji në fjalë nuk ka ofruar stimulim investues dhe nuk ka pasur një model të suksesshëm fizibiliteti. Si rezultat shumë biznese edhe pas nënshkrimit të kontratave janë larguar dhe kanë shkëputur kontratën, respektivisht obligimet e tyre në këto zona. E tilla ka qenë situata në Parkun e Biznesit në Drenas, ku nga

44 biznese sa kanë lidhur kontrata në fillim, sot vetëm 33 prej tyre kanë kontrata valide¹⁰.

Duhet theksuar se shumë zona kanë ekzistuar që para hyrjes së ligjit në fuqi. Për më tepër në këto zona kanë filluar punimet edhe para aprovimit të ligjit dhe kjo ka krijuar mos-koordinim në mes të ligjit dhe zonës, e cila ka rezultuar në dështimin e disa zonave, siç është rasti me Parkun e Biznesit në Skenderaj. Miratimi i ligjit pas krijimit të zonave ekonomike ka bërë që shumë syresh sot të vazhdojnë së funksionuari ndonëse nuk janë të legalizuara. Përpos Parkut të Biznesit në Drenas, i cili është iniciuar nga vetë institucionet publike qendrore, si dhe Parkut të Biznesit në Skenderaj, i cili ka dështuar, të tjerat ende nuk janë plotësisht të legalizuara, respektivisht u mungon dokumentacioni i plotë i dorëzuar në Agjencinë për Promovimin e NVM, në bazë të të cilave agjencia e lëshon vendimin për legalizim.

Po të shohim Ligjin dhe udhëzimet administrative, do të vërejmë një mungesë ligjore për raste të tilla. Në UA për procedurën për aplikim dhe kriteret e pajisjes me vendim të zhvilluesit, neni 4 pika 1.1. thuhet se në rast të mungesës së dokumentacionit, aplikuesit të zonës i jepet një afat prej 30 ditësh për plotësimin e dokumenteve, por as në këtë UA e as në të tjerat nuk shpjegohet se çfarë ndodh me zonat ekonomike të cilat nuk arrijnë të legalizohen. Megjithatë, ato vazhdojnë të funksionojnë dhe të promovohen edhe nga vetë Agjencia për Promovimin e NVM, e cila në faqen zyrtare të saj ka të publikuar një broshurë në të cilën promovohen të gjitha zonat ekonomike (të legalizuara ose jo). Në disa komuna, siç është rasti me Komunën e Suharekës, janë duke u bërë përgatitjet për kërkesën e shpalljes së një zone të re ekonomike, ndonëse as e para ende nuk është legalizuar.

Kosova është përballur me probleme të shumta në zbatueshmërinë e Ligjit për Zonat Ekonomike, jo vetëm në aspektin se ky ligj nuk ia arriti qëllimit të tij, por edhe për faktin se nuk funksionoi si duhet. Mos efikasiteti i këtij ligji ndikoi negativisht edhe në vlerësimet e Komisionit Evropian në raportin e fundit të progresit për Kosovën për sa i përket implementimit dhe monitorimit të ligjeve, si dhe në renditjen jo të favorshme në raportin e bankës botërore "Të bërit Biznes", ku Kosova vlerësohet me pika negative sa i përket ambientit të të bërit biznes.

Modelet e suksesshme të Zonave Ekonomike në botë dhe rajon

Meqenëse Ligji aktual për Zonat Ekonomike nuk tregoi sukses, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë gjatë përpilimit të planit vjetor për vitin 2012 morri vendim që të ndryshojë ligjin, me qëllim që ta bëjë atë sa më funksional.

¹⁰ Mediat vendore, 26 Maj 2011: Gazeta Express, KTV, RTK, Portali kosova.info, telegrafi, etj

Andaj, që Ligji i ri të jetë sa më funksional dhe t'ia arrijë qëllimit të tij, vlen të shikohen disa nga modelet më të suksesshme të zonave ekonomike në botë, nga të cilat mund të nxirren mësim gjatë ndryshimit të ligjit për zonat ekonomike në Kosovë.

Një ndër shtetet më të suksesshme në rajon për funksionalizimin e zonave ekonomike është Maqedonia. Maqedonia është treguar tejet e suksesshme sidomos në zonat përreth Shkupit, Tetovës dhe Stipit. Qeveria maqedonase përpos dhënies së tokave në shfrytëzim me çmim shumë atraktiv, ka ofruar edhe lirime nga taksat për 3-10 vitet e para të operimit të biznesit (e kjo varësisht nga lloji i biznesit prodhues) si dhe lirime nga tatimi në fitim për 50% në 5 vitet e para për punonjësit maqedonas të cilët i punëson firma¹¹. Për më tepër vetë qeveria është angazhuar në ofrimin e ndihmave dhe trajnimeve për zhvillimin e këtyre bizneseve pa pagesë me qëllim që t'i joshë investitorët drejt Maqedonisë, përkundër shteteve tjera në Ballkan. Madje varësisht nga lloji i biznesit prodhues, shteti maqedonas po e promovon vendin edhe me fuqinë e lirë punëtore, sidomos në sektorin e bujqësisë dhe industrisë. Statistikat tregojnë se ka pasur rritje ekonomike kurse trendi i investitorëve të huaj ka shënuar rritje të vazhdueshme madje edhe gjatë krizës financiare globale (ndonëse jo me ritmin e njëjtë të zhvillimit)¹². Qeveria maqedonase po ofron edhe kushte të volitshme për qasje në financim për kompanitë investuese në vend. Megjithatë, raporti për politikat investuese në Republikën e Maqedonisë 2009-2014 flet për promovimin e zonave ekonomike kryesisht për investitorët të orientuar për eksport, e cila ka ndikuar që bizneset e tjera prodhuese të mos e konsiderojnë Maqedoninë si një vend atraktiv për të investuar, andaj edhe është rekomanduar të bëhet rishqyrtimi i ligjit dhe modifikimi i tij edhe në bizneset e tjera jo-eksportuese, respektivisht ekonomitë vendore.

Edhe Turqia ka një model shumë të suksesshëm të zonave ekonomike e cila është e njohur sidomos me ndarjen e zonave në bazë të veprimtarive siç është zona për përpunimin e arit, ajo për bujqësi si dhe ajo për tekstil. Ky shtet ofron kushte shumë të volitshme dhe të përshtatshme për një sektor specifik. Turqia ka arritur t'i mbledh nëpër zonat ekonomike prodhuesit duke iu ofruar edhe stimulime shtesë siç janë lirimet nga taksat, përfitime qeveritare sipas kuantitetit të eksportit, etj. Kompanitë investuese në zonat ekonomike janë të liruara nga taksat për 3-5 vitet e para të funksionimit të biznesit¹³, kjo me qëllim që biznesi të ketë kohë të mjaftueshme që ta merr veten; si dhe për çdo kamion eksportues qeveria ofron stimulim financiar me qëllim që të rrisë eksportin dhe të përfitojë sa më shumë tregje të reja. Përfitimet fillestare nga kompanitë investuese në këto zona janë rritja e punësimit dhe gjenerimi i prodhimit, ndërsa në të ardhmen ka edhe përfitime tjera nga taksat dhe mundësia e rritjes së këtyre kompanive.

¹¹ Ligji për Zonat e zhvilluara industriale dhe teknologjike , <http://www.fez.gov.mk/>

¹² Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim, " Rishikimi I Politikave Investuese në Republikën e Maqedonisë", 2011

¹³ Ligji Nr. 3218 për Zonat Ekonomike, Qershor 1985

Kina njihet si ndër vendet me zona më të suksesshme ekonomike, e cila ka tërheq vëmendjen e fabrikave prodhuese nga mbarë bota, që nga prodhimet elektronike e deri te ato të tekstit. Këto zona i kanë sjellë të ardhura të mëdha Kinës, dhe janë një ndër faktorët kryesor që Kina sot të njihet si një ndër shtetet me kapacitetin më të madh tregtar dhe eksportues në botë. Kina si një shtet me ekonomi të zhvilluar, përveç krijimit të zonave ekonomike, ajo investitorëve të saj u ofroi sektorizimin e zonave në bazë të profesioneve të caktuara, duke iu ofruar njëherazi edhe kushte më të volitshme për atë lloj prodhimi, si dhe fuqinë e lirë dhe të specializuar punëtore. Duke i njohur kapacitetet e veta, ajo vendosi të specializohet më shumë në prodhimin e teknikës dhe tekstit, prandaj edhe ndarjen e zonave ekonomike është bërë në bazë të këtyre dy profesioneve, ku secila zonë ofron kushte më të përshtatshme investuese për atë lloj profesioni. Kështu zonat e specializuara për teknikë ofrojnë kushte më të mira investuese sa i përket rrjetit të internetit, programeve të sofistikuar për prodhimin teknik, fuqia punëtore është më profesionale etj., përderisa zonat e specializuara për tekstil kanë qasje më të lehtë në burimet e tekstit, kanë fuqinë punëtore më të lirë, etj¹⁴.

Përfundime dhe Rekomandime

- Në Kosovë janë krijuar gjithsej 10 zona ekonomike në gjithsej 8 komuna të ndryshme të Kosovës. Nëpër komuna ato njihen si parqe të biznesit, parqe industriale apo si inkubatorë të biznesit.
- Megjithëse ligji ekziston që nga viti 2009, vetëm dy zona ekonomike kanë arritur të legalizohen nga ana e Qeverisë, Parku i Biznesit në Drenas dhe Parku Teknologjik në Skenderaj. Ky i fundit ka dështuar krejtësisht si projekt.
- Në përgjithësi punimet në ndërtimin e infrastrukturës në parqet e bizneseve kanë shkuar ngadalë. Kjo ka dekurajuar shumë firma përfituese të parcelave të cilat edhe kanë bërë shkëputje të kontratës. Në disa parqe punimet kanë ngecur në gjysmë dhe projekti mund të dështojë tërësisht.
- Mos ndarja e zonave ekonomike në bazë të veprimtarive specifike, ka bërë që brenda një zone të operojnë biznese të ndryshme, që për nga natyra e veprimtarisë nuk do të duhej të ishin pranë njëra tjetrës. Kështu brenda një parku ka deponues të gazit dhe çerdhe fëmijësh, ka kultivues të perimeve dhe përpunues të metaleve.
- Në disa inkubatorë të biznesit nuk operon asnjë biznes i vetëm, kurse hapësirat e objektit i janë dhënë organizatave të ndryshme jo qeveritare. Shumica janë të liruara nga qiraja.

¹⁴ Yue-man Yeung, Joanna Lee, dhe Gordon Kee. "Zonat Ekonomike Speciale të Kinës" Gjeografija dhe Ekonomia Vol. 50, nr. 2 (2009) Pg. 224;
Kwan-Yiu Wong. "Ekperimenti me Zonat e veçanta ekonomike të Kinës: Një vlerësim" Gjeografija dhe Ekonomika Njerëzore Vol. 69, nr. 1 (1987). Pg. 29

- Për shkak të procedurave burokratike shumica e parqeve të biznesit nuk e kanë fituar statusin e zonës ekonomike nga MTI. Megjithatë, ato operojnë në bazë të lejes së lëshuar nga komuna përkatëse.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Zonat Ekonomike është futur në programin legjislativ të Qeverisë së Kosovës për vitin 2012 dhe pritet të miratohet në fund të muajit prill. Andaj gjatë hartimit të ligjit të ri për zonat ekonomike, Institucionet vendore duhet të marrin për bazë modelet e suksesshme të zonave ekonomike në botë dhe rajon dhe t'i përshtatin ato me mundësitë që mund t'i ofrojë Kosova. Kështu, Instituti GAP rekomandon që Ligji i ri për zonat ekonomike të përmbajë sugjerimet e më poshtme:

- Të ofrohen stimulues financiar, respektivisht të ofrohen mundësitë e lirimit nga taksat për biznesin për 3-5 vitet e para si dhe lirim nga taksat për punëtorët vendor prej 30-50% për 1-3 vitet e para;
- Të ofrohen stimulues jo-financiar, respektivisht qasje më e lehtë në shërbimet e nevojshme për biznesin, siç janë rrymë dhe ujë 24 orë, qasje të lehtë dhe të shpejtë në aeroport, hekurudhë, autostradë, etj;
- Të ofrohet mundësia e qasjes më të lehtë në financimin e kapitalit investues, qoftë përmes ofrimit të kredive me kushte të volitshme, përpilimit të bazës ligjore për krijimin e kompanive investuese ("Business angels") apo krijimit të institucionit financiar për zhvillimin e bizneseve. Si mundësi tjetër mund të jetë edhe rritja e fondeve për Agjencinë për Promovimin e NMV e cila do t'u ofronte kapital bazë investues në bazë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht (numri i të punësuarve, kapitali investues nga vetë kompania investuese, etj);
- Të bëhet specializimi i zonave ekonomike, p.sh. rajoni i Dukagjinit të jetë i specializuar për investitorët e bujqësisë, rajoni i Prishtinës për investitorët e teknologjisë, rajoni i Prizrenit për investitorët zanatlinj (përpunimi i arit, argjendit), etj;
- Të ofrohen mekanizma dialoguese, respektivisht të ofrohet mundësia e krijimit të zonave nga zhvilluesi privat, publik apo publiko-privat;
- Të lehtësohen procedurat burokratike dhe numri i madh i dokumentacioneve të nevojshme për aplikim për zonë ekonomike, e cila edhe ka rezultuar që shumica e zhvilluesve të zonave ekonomike të mos e kompletojnë dokumentacionin e nevojshëm;
- Të plotësohet ligji me mungesat aktuale ligjore, siç është rasti se si duhet vepruar nëse zhvilluesi i zonës ekonomike nuk i përmbush të gjitha dokumentacionet e nevojshme. Të bëhet e qartë masa ndëshkuese dhe afati kohor;
- Të përmirësohet komunikimi ndërmjet akterëve kyç për zhvillimin e zonave ekonomike (ministritë përkatëse, odat ekonomike që veprojnë në Kosovë, agjencisë për promovimin e NMV) dhe përpilimin e raporteve vjetore për gjendjen e zonave ekonomike, e cila më pas do t'u shpërndahej investitorëve potencial vendor dhe ndërkombëtar;

- Krejt në fund, MTI duhet të krijojë një strategji për promovimin e ligjit të ri, pasi se shumë biznese nuk kanë qenë të informuar me përfitimet që i ofrojnë këto zona.



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.